

Neser ne oren 20:15 Luksemburg - Shqiperi

nga Administrator

E hënë, 28 Mars 2016 21:59



Neser ne oren 20:15 ne stadiumin Josy Barthel do te luhet ndeshja miqesore Luksemburg - Shqiperi. Ekipi yne kombetar ka mberritur sot mbasdite ne Luksemburg ku ka zhvilluar edhe nje seance stervitore ne stadiumin ku do te zhvillohet ndeshja. Ne oren 19:00 tranjeri De Biasi ka mbajtur nje konference per shtyp ku ka folur per ndeshjen e rradhes kunder Luksemburgut. "Do te kemi disa ndryshime ne raport me ndeshjen e pare kunder Austrise"- deklaroi trajneri De Biasi. "Do te aktivizohen nje pjese e futbollisteve, te cilet nuk u aktivizuan ne takimin e pare", shtoi ai. "Sigurisht do te provojme dicka ndryshe, sepse edhe kundersharet nuk jane te njejte"- tha trajneri i kombetares. Ashtu si edhe ne ndeshjen kunder Austrise, pritet qe ne stadium te kete nje numer te madh tifozesh.